

**AKT THEMELIMI
I SHOQERISE "UNIVERSITETI POLIS" S.H.P.K.**



Sot me dt. 30/3/2006 personat fizik :

Besnik Aliaj, datelindja 13 shtator 1966, lindur ne Gjirokaster dhe banues ne Tirane, madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, i identifikuar nga pasaporta me nr. Z0593086.

Dritan Shutina, datelindja 8 shkurt 1971, lindur ne Tirane dhe banues ne Tirane, madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, i identifikuar nga pasaporta me nr. Z0779281.

Gazmend Haxhia, datelindja 7 qershor 1968, lindur ne Tirane dhe banues ne Tirane, madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, i identifikuar nga pasaporta me nr. Z0787828.

Klement Kolaneci, datelindja 25 mars 1948, lindur ne Tirane dhe banues ne Tirane, madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, i identifikuar nga pasaporta me nr. Z1230488.

Sotir Dhamo, datelindja 12 Maj 1965, lindur ne Tirane dhe banues ne Tirane, madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, i identifikuar nga pasaporta me nr. Z1714876.

Mbeshtetur ne Ligjin Nr.7638 , date 11 nentor 1992 "Per Shoqerite Tregtare" dhe ne Legjislacionin shqiptar ne pergjithesi, personiat fizik te mesiperm, kane vendosur si me poshte".

Emertimi, Selia dhe afati i Shoqerise

Neni 1

Te themelojne shoqerine me pergjegjesi te kufizuara , per te zhvilluar veprimtari private. Shoqeria eshte person juridik Shqiptar, veprimtaria e te ciles rregullohet nga kjo kontrate, Statuti i saj dhe Legjislacioni ne fuqi.

Neni 2

Shoqeria do te emertohet "Universiteti POLIS " shpk.

Neni 3

Shoqeria do te kete seline ne Tirane, Rruga : "Vaso Pasha", kati 1-3, (mbrapa fakultetit te Drejtesise).

Neni 4

Shoqeria do te zhvilloj aktivitetin e saj me afat te pakufizuar. Ky afat mund te zgjatet ose te shkurtohet me vendim te Asamblese se ortakeve. Shoqeria " Universiteti POLIS" shpk gezon statusin e personit juridik nga momenti i regjistrimit si e tille ne regjistrin tregtar te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

Neni 5

Shoqeria " Universiteti POLIS " SHPK. do te kete si objekt: Krijimin e Universitetit "POLIS", Shkolla Nderkombetare e Arkitektures dhe Politikave te Zhvillimit Urban, me Dege Arkitekture - Urbanistike dhe Planifikim Urban.

Neni 6

Shoqeria ushtron aktivitetin e saj ne Tirane, por, nese do te jete e nevojshme edhe mbi baze dege ne qytete te tjera te vendit, te cilat mund hapen pasi te kete filluar dore dore aktiviteti i shoqerise.

Neni 7

Selia e shoqerise mund te transferohet.

Neni 8

Kapitali i shoqerise eshte i perbere nga ortaket e saj dhe i depozituar ne zyren Noteriale ku legalizohen keto dokumente.

Kur shoqeria pushon veprimtarine e saj, pasi shlyen te gjitha detyrimet qe ka, pjesen e mbetur te kapitalit dhe te te ardhurave i perfitojne ortaket e saj.

Fitimi neto i realizuar nga shoqeria, mbasi zbriten te gjitha detyrimet si edhe fondet e lena rezerve per nxitjen ekonomike, per investime, per reklamen tregtare etj. perfitohen prej ortakeve themelues te kesaj shoqerie.

Ortaket themelues perballojne humbjet e shoqerise deri ne kufirin e vleres se tij te derdhur ne formimin e kapitalit themeltar. Kapitali baze mund te ritet nga fitimi ne natyre, ose kredi ne leke ose valute qe merret ne Bankat e Shtetit Shqiptar, Bankat e marredhenieve me

Jashte ,Bankat Private ose nga cdo person tjeter fizik e juridik Shqiptar ose i huaj.

Kapitali themeltar per vazhdimin e aktivitetit te shoqerise eshte ne shumen 100.000 (Njeqindmije) Leke,i cili zoterohet nga ortaket Besnik Aliaj, Dritan Shutina, Gazmend Haxhia, Klement Kolaneci, Sotir Dhamo.

Neni 9

Fitimi qe do te realizohet nga aktiviteti i kesaj shoqerie i takojne ortakeve Besnik Aliaj, Dritan Shutina, Gazmend Haxhia, Klement Kolaneci, Sotir Dhamo.

E ardhura bruto e shoqerise,pasi zbritet amortizimi i te gjithë pasurise se lujteshme e te palujteshme, sipas afateve te caktuara, kuotat qe kane te bejne me kredite per investimet, pagat e shesat mbi pagat, shpenzimet per lendet e para apo ndihmese e energjine si dhe shpenzimet e pergjithshme te saksioneve te shoqerise dhe ato per qellime te tjera prodhuese e joprodhuese,i takon ortakeve Fitimet qe do te rezultohen pas miratimit te bilancit vjetor nga Asambleja e Ortakeve pas zbritjes se taksave do te ndahen si vijon:

Fondi rezerve:

Shperblimi qe i takon ortakeve themelues ndahet si vijon:

Besnik Aliaj 21,5%

Dritan Shhtina 19,5%

Gazmend Haxhia 20%

Klement Kolaneci 19,5%



Sotir Dhamo 19,5%

Neni 10

Shoqeria mund te hyje ne veprimtari te perbashketa me shoqeri te tjera shqiptare ose te huaja edhe kur ato nuk kane objekt aktiviteti ate te shoqerise.

Neni 11

Veprimtaria e shoqerise mund te ushtrohet duke krijuar filiale ose perfaqesi brenda dhe jashte vendit, ne konformitet me ligjin shqiptar ose te huaj.



TE DREJTAT DHE DETYRAT E ORTAKUT

Ortaku gëzon keto të drejta kryesore:

Neni 12

1. Administrimin e veprimtarisë në përputhje me kontratën dhe statutin.
2. Pjesëmarrjen në rezultatet e çdo forme dhe sasi të veprimtarisë së shoqërisë e parashikuar në kontratën dhe statutin e saj.
3. Marrjen e të gjitha të dhënave që kanë të bëjnë me gjendjen ekonomike tregtare dhe veprimtarinë e shoqërisë, si dhe me të gjithë dokumentat e përpunuara nga shoqëria, bilancet si dhe llogaritë ekonomike, etj.
4. Paraqitjen e propozimeve dhe shqyrtimin e tyre nga Mbledhja e Asamblese dhe organet e tjera të shoqërisë.
5. Heqja dorë nga shoqëria nuk e liron ortakun nga detyrimet financiare të marra me parë ndaj shoqërisë.
6. Të marrë pjesë në organet e shoqërisë që janë ose mund të krijohen nëpërmjet përfaqësuesve të tij ose vetë.
7. Të kërkojë t'i japin të gjitha informatat që kanë të bëjnë me gjendjen prodhuese dhe tregtare të shoqërisë, si dhe të gjithë dokumentat e përpunuara të shoqërisë, si bilancet, llogaritë ekonomike, etj.
8. Të bëjë propozime dhe t'i paraqesë ato për shqyrtim para organeve të shoqërisë.
9. Të emerojë dhe të shkarkojë përfaqësuesit e saj, punonjësit, ekspertin kontabel dhe likuidatorët.

Ortaku ka keto detyrime kryesore:

1. Të depozitojë kuotën e tij dhe kuotën suplementare në përputhje me kontratën dhe statutin.
2. Të marrë pjesë në administrimin e shoqërisë nëpërmjet organeve të krijuara nga vetë shoqëria.
3. Të japë shoqërisë të dhënat e domosdoshme për përpunimin e çdo objekti të vecantë lidhur me veprimtarinë e saj.
4. Të kryejë detyrat për realizimin e objektivave dhe të funksioneve të shoqërisë.



5. Ka detyrimin nese heq dore nga shoqeria ti njoftoj vendimin e tij asamblese 6 muaj perpara dhe duke ceduar te drejten e zgjedhjes .
6. Ti japi shoqerise informatat e nevojshme qe kane te bejne me ecurine e veprimtarise se saj.
7. Te kryeje sherbimet e nevojshme per arritjen e objektivave te shoqerise dhe realizimin e funksioneve te saj.

ADMINISTRIMI

Neni 13

Organi vendimor i shoqerise eshte Asambleja e Ortakeve.

Sipas rendesise se vendimeve mbledhja e Asamblese mund te jete:

Asambleja e zakonshme dhe Asambleja e jashtezakonshme

Neni 14



ADMINISTRATORI

Veprimtaria operative e shoqerise drejtohet nga Administratori i saj i Pergjithshem. Ne shoqerine "Universiteti POLIS " SH.P.K Administrator i Pergjithshem eshte Sotir Dhamo, i cili ne te njejten kohe ka edhe funksionin e perfaqesimit te shoqerise me te tretet ne gjithë veprimtarine e tij. Administratori dhe cdo perfaqesues i shoqerise "Universiteti POLIS" sh.p.k. emerohen me miratimin e ortakeve. Administratori emerohet per nje kohezgjatje prej tre vjetesh financiare me perjashtim te rasteve te doreheqjes ose shkarkimit te parakohshem. Administratori ka te gjitha kompetencat per te kryer te gjitha veprimet me interes te shoqerise dhe ne emer te saj nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e veprimtarise se shoqerise me perjashtim te atyre kompetencave qe ligji nuk i njeh. Administratori eshte pergjegjes individualisht ndaj shoqerise apo te treteve per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit apo per faj te tij gjate administrimit te shoqerise.

MBYLLJA E SHOQERISE

Neni 15

Veprimtaria e shoqerise pushon me propozimin e bere nga ortaket, kur gjate dy vjeteve nuk rezulton rentabel ose kur ortaket heqin



dore nga shoqeria si dhe te gjitha rastet qe parashikohen ne dokumentet e krijimit te shoqerise (kontrata).
Shoqeria shperndahet ne forme riorganizimi ose likujdimi.

LIKUJDIMI I SHOQERISE

Neni 16

Asambleja e ortakeve emeron komisionin e likujdimit, te cilit i paraqitet bilanci i likujdimit dhe shoqeria i jep fund veprimtarise se saj ne castin e miratimit te ketij bilanci. Komisioni i Likujdimit perbehet nga tre antare. Pasurite qe jane vene ne dispozicion te shoqerise me te drejte shfrytezimi, shiten ne vartesi te shkalles se konsumimit te tyre. Te ardhurat cedohen ndermjet ortakeve ne perpjestim me kuoten e vene.

Mjetet financiare te fituara si rezultat i veprimtarise se shoqerise e te filileve te saj dhe fondet financiare ndahen ndermjet ortakeve ne perpjestim me kuotat e vena ,pasi te jene bere pagesat per kreditorët.

Neni 16

Kur pushon veprimtaria e nje filiali, per efekte te riorganizimit te tij, afatet e pushimit caktohen nga Asambleja e Ortakeve. Likujdimi i filialeve behet njelloj si per shoqerine.

Mjetet financiare te fituara si rezultat i veprimtarise se filialit te likujduar dhe fondet e tij financiare vihen ne dispozicion te shoqerise pasi t'u jene bere pagesat likujdatoreve.

Dispozita te hollesishme mbi organizimin e kesaj shoqerie percaktohen ne statutin e saj.

ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE

Besnik Aliaj

Dritan Shutina

Gazmend Haxhia

Gazmend Haxhia

Klement Kolaneci

Sotir Dhano

Sotir Dhano

STATUT
PER VEPRIMTARINE E SHOQERISE
" Universiteti POLIS " SHPK

KREU I

Dispozita te Pergjitheshme

NENI 1.

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "Universiteti POLIS" SH.P.K, eshte themeluar sipas kontrates dhe ketij statuti te perpiluara dhe nenshkruara nga ortaket e saj:

Besnik Aliaj, datelindja 13 shtator 1966, lindur ne Gjirokaster dhe banues ne Tirane,madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar,i identifikuar nga pasaporta me nr. Z0593086.


Dritan Shutina, datelindja 8 shkurt 1971, lindur ne Tirane dhe banues ne Tirane,madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar,i identifikuar nga pasaporta me nr. Z0779281.

Gazmend Haxhia, datelindja 7 qershor 1968, lindur ne Tirane dhe banues ne Tirane,madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar,i identifikuar nga pasaporta me nr. Z0787828.

Klement Kolaneci, datelindja 25 mars 1948, lindur ne Tirane dhe banues ne Tirane,madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar,i identifikuar nga pasaporta me nr. Z1230488.

Sotir Dhamo, datelindja 12 Maj 1965, lindur ne Tirane dhe banues ne Tirane,madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar,i identifikuar nga pasaporta me nr. Z1714876.

Kjo shoqeri ne perputhje me Legjislacionin shqiptar, vecanerisht me Ligjin nr. 7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite Trgtare", krijohet nga "ORTAKET " per te ushtruar veprimtari te perbashket sipas parashikimeve te bera ne Aktin e Themelimit dhe nga ky Statut.



Emertimi i shoqerise eshte "Universiteti POLIS" SH.P.K. Shoqeria e percaktuar ne nenin 1 te ketij statuti eshte krijuar me mjetet ne pronesi private te themeluesve te saj.

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "Universiteti POLIS" sh.p.k. ushtron veprimtarine e saj ne perputhje me vendimin per krijimin e kesaj shoqerie (kontraten dhe statutin) dhe legjislacionin shqiptar. Ajo regullon poziten juridike te themeluesve dhe punonjesve ne shoqeri, te dhenat me rendesi per qarkullimin juridik, organizimin, objektin e veprimtarise dhe ceshtje te tjera me rendesi per punen e shoqerise.

Shoqeria "Universiteti POLIS" SH.P.K eshte person juridik Shqiptar dhe e fiton kete te drejte qe nga momenti i regjistrimit te shoqerise ne regjistrin tregtar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane .

Shoqeria ka vulen e saj ne forme rrethore me madhesi te zakonshme shkruar "Universiteti POLIS " sh.p.k.

Shoqeria kryen veprimtarine e saj per te realizuar fitimin e saj duke u mbeshtetur ne parimet e likuiditetit, sigurise dhe te rentabilitetit.

NENI 2

OBJEKTI

Krijimi i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "Universiteti POLIS", Shkolla Nderkombetare e Arkitektures dhe Politikave te Zhvillimit Urban, me Dege Arkitekture - Urbanistike dhe Planifikim Urban.

NENI 3

Shoqeria e ka qendren e saj ne Tirane, Rruga : "Vaso Pasha", kati 1-3, (mbrapa fakultetit te Drejtesise).

Ajo mund te çele filiale,dege dhe perfaqesi ne qytete te tjera te Shqiperise dhe jashte saj, ne perputhje me Legjislacionin Shqiptar.

NENI 4.

Shoqeria pergjigjet per detyrimet e saj me fondet e veta.


KREU II

TE DREJTAT DHE DETYRAT E ORTAKUT

NENI 5

Ortaku gezon keto te drejta kryesore:

1. Administrimin e veprimtarise ne perputhje me kontraten dhe statutin.
2. Pjesmarrjen ne rezultatet e cdo forme dhe sasive te veprimtarise se shoqerise e parashikuar ne kontraten dhe statutin e saj.
3. Marrjen e te gjitha te dhenave qe kane te bejne me gjendjen ekonomike tregtare dhe veprimtarine e shoqerise, si dhe me te gjitha dokumentat e perpunuara nga shoqeria, bilancet si dhe llogarite ekonomike, etj.
4. Paraqitjen e propozimeve dhe shqyrtimin e tyre nga Mbledhja e Asamblese se Ortakeve dhe organet e tjera te shoqerise.
5. Te heqi dore nga shoqeria.
6. Heqja dore nga shoqeria nuk e liron ortakun nga detyrimet financiare te marra me pare ndaj shoqerise.
7. Te marri pjese ne organet e shoqerise qe jane ose mund te krijohen nepermjet perfaqesuesve te tije ose vete.
8. Te kerkoje t'i jepen te gjitha informatat qe kane te bejne me gjendjen prodhuese dhe tregtare te shoqerise, si dhe te gjitha dokumentat e perpunuara te shoqerise, si bilancet, llogarite ekonomike, etj.
9. Te beje propozime dhe t'i paraqesi ato per shqyrtim para organeve te shoqerise.
10. Te emeruje dhe te shkarkoje perfaqesuesit e saj, punonjesit, ekspertin kontabel dhe likuidatoret.



NENI 6

Ortaku ka keto detyrime kryesore:


1. Te depozitoje kuoten e tij ne perputhje me kontraten dhe statutin.
2. Te marri pjese ne administrimin e shoqerise nepermjet organeve te krijuara nga vete ai.
3. Ti jape shoqerise te dhenat e domosdoshme per perpunimin e cdo objekti te vecante lidhur me veprimtarine e saj.
4. Te kryej detyrat per realizimin e objektivave dhe te funksioneve te shoqerise.
5. Sejcili ortak ka te drejte te heqe dore nga shoqeria, duke i njoftuar vendimin e tij asamblese se ortakeve 6 muaj perpara dhe duke ceduar te drejten e zgjedhjes.
6. Heqja dore nuk e liron ortakun nga detyrimet e marra me pare ndaj shoqerise dhe nuk pezullon detyrimet e shoqerise ndaj ortakut.
7. Ti japi shoqerise informatat e nevojshme qe kane te bejne me ecurine e veprimtarise se saj.
8. Te kryeje sherbimet e nevojshme per arritjen e objektivave te shoqerise dhe realizimin e funksioneve te saj.
9. Pjesemarrja ne shoqeri nuk e pengon ortakun te kete pavaresi ligjore per veprimtari te tjera dhe per te drejta te tjera pronesie. Ai nuk pergjigjet per detyrimet e shoqerise qe rrjedhin nga objekti i veprimtarise se saj pertej kapitalit themelor ku ata kane marre pjese.

KREU III

KUSHTET EKONOMIKE

NENI 7

Verimtaria e shoqerise realizohet ne baze te leverdise ekonomike dhe pasqyrohet ne bilancet e saj. Bilanci vjetor i shoqerise nxirret brenda 31 Marsit te vitit pasardhes. Cdo vit financiar fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor.



NENI 8

Llogarite vjetore inventari, raportet operacionet e veprimtarise se vitit financiar dhe raportet e vecanta te hartuara nga administratori dhe eventualisht nga eksperti kontabel i autorizuar miratohen nga Asamblea. Miratimi i dokumentave mbi veprimtarine vjetore behet brenda nje afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes se vitit financiar.

NENI 9

Per te bere te mundur zhvillimin e veprimtarise se shoqerise, vihet nje kapital baze qe perben burimin fillestar per krijimin e fondit themelor dhe te mjeteve te xhiros.

NENI 10

Ortaket marrin pjese ne krijimin e kapitalit baze me kontributin e tij te vetem qe percaktohet ne kontraten per krijimin e shoqerise.

NENI 11


Kur shoqeria pushon veprimtarine e saj, pasi shlyen te gjitha detyrimet qe ka, pjesen e mbetur te kapitalit dhe te te ardhurave e marrin ortaket themelues.

Fitimi neto i realizuar nga shoqeria, mbasi zbriten te gjitha detyrimet si edhe fondet e lena rezerve per nxitjen ekonomike, per investime, per reklamen tregtare etj.perfitohen prej ortakeve themelues te kesaj shoqerie.

Ortaket perballojne humbjet e shoqerise deri ne kufirin e vleres se derdhur ne formimin e kapitalit themeltar. Ne rast zmadhimi te kapitalit themeltar nepermjet shtimit te tij ortaket kane te drejten e rritjes se tij.

Pjeset e kapitalit themeltar jane plotesisht te transferueshme ne rruge trashegimie ne rast ndarje pasurie ndermjet bashkeshorteve dhe nepermjet paraardhesve dhe pasardhesve.

Transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar duhet te vertetohet me akt noterial.



Shoqeria ne emer te vet eshte pronare, perdoruese dhe disponuese e pasurive te saj, por gjithmone ne perputhje me qellimin e objektin e veprimtarise qe ajo kryen.

Shoqeria mund te shese pasuri ose te shfrytetoje te drejta te tjera materiale. Ajo mund te ofroje per garanci edhe pasuri te saj per te marre kredi bankare.

Shoqeria krijon fonde rezerve ose dhe fonde te tjera te vecanta per zhvillimin dhe nxitjen ekonomike te saj.

Shoqeria disponon mjetet e veta financiare. Detyrimet eventuale qe mund te lindin gjate veprimtarise se saj mbulohen nga fondi rezerve, nga fondet e tjera ose nga shumet suplementare qe kur deshirojne mund te derdhen prej ortakeve, ne rastet kur keto detyrime nuk mund te mbulohen nga fondet ekzistuese.

NENI 12.

Shoqeria eshte pronare e pasurive te saj dhe ka te drejte te perdorimit dhe disponimit te kesaj pasurie, ne perputhje me qellimin dhe objektin e veprimtarise qe kryen.

Shoqeria gezon te drejtat per mbrojtjen e pasurise se saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar.


NENI 13

Shoqeria krijon fondin rezerve dhe fonde te tjera te vecanta per financimin e zhvillimin e saj, per nxitjen e ekonomise ,etj.

Perberja, shuma e pergjithshme, burimet per krijimin e fondit rezerve, perdorimi dhe rregullimi i cdo fondi te vecante caktohen nga Asamblea e Pergjithshme ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

Shoqeria disponon plotesisht mjetet e saj financiare.

Detyrimet qe mund te lindin gjate veprimtarise se saj, mbulohen nga fondi rezerve dhe nga fondet e tjera, ose nga shumet suplementare qe mund te derdhen ortaket, kur detyrimet nuk mund te mbulohen nga fondet egzistuese.



NENI 14

E ardhura bruto e shoqerise, pasi zbritet amortizimi i te gjithë pasurise se lujteshme e te palujteshme, sipas afateve te caktuara, kuotat qe kane te bejne me kredite per investimet, pagat e shtesat mbi pagat, shpenzimet per lendet e para apo ndihmese e energjine si dhe shpenzimet e pergjithshme te saksioneve te shoqerise dhe ato per qellime te tjera prodhuese e joprodhuese, i takojne ortakeve te shoqerise.

KREU IV

ADMINISTRIMI

NENI 15


Organi vendimor i shoqerise eshte Asamblea e Ortakeve

Mbledhja e Asamblese mund te thirret nga administratori, nga eksperti kontabel i autorizuar ose nga likuiduesit.

Sipas rendesise se vendimeve mbledhja e Asamblese mund te jete e *zakonshme* ose e *jashtezakonshme*.

Asambleja e zakonshme vendos :

1. Per ceshtje te tilla si emerimin ose shkarkimin e personelit sipas strukturave te ngritura nga shoqeria, ekspertin kontabel te autorizuar dhe likuiduesit.
2. Miratimin e raporteve te administrimit dhe kontrollit, per :
 - Ndryshimet e statutit.
 - Rritjen dhe pakesimin e kapitalit baze.
 - Miratimin e programit vjetor te veprimtarise se shoqerise.
 - Per fitimin dhe rezultatet.
 - Kohezgatjen e veprimtarise se shoqerise.
 - Pushimin e veprimtarise se shoqerise.
3. Ne te marrin pjese ortaket e saj per: miratimin e llogarive vjetore dhe percaktimin e fitimit.



Asambleja e jashtezakonshme vendos:

1. Per ceshtje te tilla si ndryshimin e statutit;
2. Zvogelimin e pjeseve te kapitalit themeltar;
3. Zmadhimin e kapitalit themeltar;
4. Transferimin e pjeseve te kapitalit themeltar;
5. Shnderrimin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar ne forma te tjera;
6. Mbylljen e shoqerise para kohe.


Asambleja thirret se paku nje here ne vit, duke lajmeruar me shkrim 30 dite perpara.

NENI 16

Asambleja e Ortakeve merr vendime per cdo aspekt te veprimtarise se shoqerise.

Kompetencat ekzekutive te Asamblese se Ortakeve te shoqerise jane:

1. Percaktimi i te drejtave kryesore te veprimtarise se shoqerise.
2. Ndryshimet ne emertesin e aktivitetit qe do te realizohet dhe te veprimtarise qe do te kryhet, qe jane pjese perberese e objektit te veprimtarise se shoqerise.
3. Propozimet e nevojshme per ndryshimet ne kapitalin baze te shoqerise.
4. Percaktimi i regjimit dhe i kushteve te zbatimit te parimeve te llogarise ekonomike.
5. Percaktimi i rregullave dhe i normave, qe perkufizojne raportet me gjirin e shoqerise, duke perfshire edhe kuadrin e personelit.
6. Percaktimi i strukturese se aparatit te shoqerise.
7. Percaktimi i organikes dhe ndarja e vendeve drejtuese ndermjet perfaqesive te ortakeve.
8. Emertimi dhe zevendesimi i Administratorit te pergjithshem te shoqerise.
9. Krijimi i organeve te tjera te domodoshem per realizimin e objektiveve te shoqerise.





10. Percaktimi i madhësisë së kuotave për formimin e kapitalit baze të shoqërisë.
11. Paraqitja e propozimeve për rregullimin, krijimin dhe përfitimin nga fondet e vecanta, ndarjen e fitimeve dhe percaktimi i rregullave për shlyerjen e borxheve.
12. Marrja e vendimit për krijimin e filialeve të degeve e të përfaqësive si dhe për cedimin e veprimtarisë së tyre.
13. Percaktimi i rregulloreve për procedurën e punës së administratës.
14. Përgatitja e propozimit për pushimin e veprimtarisë së shoqërisë.
15. Përzgjedhja e antareve për komisionin e likuidimit të cilet emerohen dhe rievokohen nga Asambleja e Ortakëve.
16. Kryerjen e veprimtarive për likuidimin e llogarive, që u perkasin ortakëve doreheqës të shoqërisë.
17. Marrjen e vendimit për kerkimin dhe përdorimin e kredive afatgjata.

NENI 17



Veprimtaria operative e shoqërisë drejtohet nga Administratori i saj. Në shoqërinë "Universiteti POLIS" SH.P.K Administratori i shoqërisë është Sotir Dhamo i cili në të njëjtën kohë ka edhe funksionin e përfaqësimit të shoqërisë me të tretet në gjithë veprimtarinë e saj. Me miratimin e ortakëve mund të emerohen administrator dhe përfaqësues të shoqërisë "Universiteti POLIS" shpk.

Administratori emerohet për një kohëzgjatje prej tre vjetësh financiare me përjashtim të rasteve të doreheqjes ose shkarkimit të parakohshëm. Administratori ka të gjitha kompetencat për të kryer të gjitha veprimet me interes të shoqërisë dhe në emër të saj nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e veprimtarisë së shoqërisë me përjashtim të atyre kompetencave që ligji nuk i njeh. Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë apo të tremeve për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit apo për faj të tij gjatë administrimit të shoqërisë.

Kompetencat e administratorit në shoqëri janë:



1. Te miratoje planet e llogarive ekonomike pas perpunitimit te tyre ne kuadrin e veprimtarise se shoqerise.
2. Te beje propozimet e nevojshme ne mbledhjen e asamblese kur lind nevoja e kapitalit themeltar te shoqerise.
3. Te miratoje akte normative qe percaktojne raportet ne gjirin e shoqerise duke perfshire kuadrin dhe personelin.
4. Te percaktoje strukturen e aparatit te shoqerise.
5. Te krijoje organe te tjera te domosdoshme per realizimin e objektivave te shoqerise.
6. Te propozoje ne mbledhjen e asamblese per krijimin e njesive, srukturave si filiale, dege e perfaqesi ne qytete te tjera te vendit apo jashte shtetit.
7. Te pergatise propozimet per pushimin e veprimtarise se shoqerise dhe t'ia paraqesin ato Asamblese per miratim.
8. Te perzgjedhe ekspertet kontabel dhe anetaret e komisionit te likuidimit dhe te paraqesin propozimet per miratim ne asamble.
9. Te siguroje zbatimin e perpikte te vendimeve te asamblese.
10. Te percaktoje numrin e punonjesve te shoqerise dhe pagat e tyre.
11. Organizon punen per realizimin e planeve te shoqerise dhe raporton per to ne perputhje me programet e planet e pergjithshme, administron pasurine e shoqerise, duke perfshire ketu mjetet financiare, brenda caqeve te vendimeve te marra nga organi administrativ i shoqerise.
12. Drejton e kontrollon veprimtarine e filialeve te degeve e te perfaqesive.
13. Perfaqeson shoqerine perpara te treteve si gjykate, etj.
14. Nenshkruan kontrata ne emer e per llogari te shoqerise dhe siguron venien e tyre ne jete.
15. Merr te gjitha vendimet qe kane te bejne me ato veprimtari te shoqerise, qe nuk jane ne kompetence ekzekutive te Asamblese se Ortakeve.
16. Raporton dhe i pergjigjet Asamblese per zbatimin e veprimtarive te shoqerise si dhe per realizimin e objektivave dhe detyrave qe jane ne kompetence te tij.
17. Siguron drejtimin e shoqerise.
18. Perfaqeson shoqerine ne lidhje me te tretet brenda caqeve te objektit te veprimtarise se saj, pervec ceshtjeve qe kerkojne



unanimitetin e ortakeve ose qe kane te bejne me kompetencat qe ky statut i atribuon Asamblese se Ortakut.

19. Organizon zbatimin e sakte te vendimeve te Asamblese se Ortakut.

20. Ben hapjen e leter kredive ne leke e ne valute te huaj.

NENI 18

Per te kontrolluar veprimtarine financiare te shoqerise e te filialeve te saj krijohet komisoni i revizionimit kontabel.

Kryetari dhe antaret e ketij komisioni emerohen nga Asambleja e Ortakeve. Kryetari i komisionit emerohet per cdo mandat nga Asambleja.

Komisioni i Revizionimit kontabel perbehet nga 3-5 vete dhe qendron ne detyre per nje periudhe prej tre vjetesh.

Kryetari dhe antaret e komisionit nuk mund te jene ne varesi te shoqerise ose filialeve te saj.

Komisioni i Revizionimit kontabel eshte pergjegjes per veprimtarine e vet perpara Asamblese se Ortakut dhe eshte i detyruar ti paraqese asaj cdo vit raport per kontrollet e bera si dhe konkluzionet per bilancet vjetore.

NENI 19

Marredheniet e punes ne shoqeri



Marredheniet e punes ne shoqeri e filiale, ne dege e perfaqesi rregullohen ne perputhje me vendimin per krijimin e shoqerise, legjislacionit shqiptar dhe me kete statut si dhe nepermjet kontrates se punes. Per ceshtjet qe nuk rregullohen ne kontraten e punes, zbatohen dispozitat e legjislacionit te punes.

Punesimi i punonjesve ne shoqeri behet mbi bazen e kontrates kolektive dhe individuale te punes.

Ne kontraten e punes rregullohen keto ceshtje:

Kushtet dhe menyra e marredhenies se punes.

Fillimi i punes se punonjesve dhe caktimi i tij ne vendin e punes.



Koha e punes dhe caktimi i kohes se punes, puna e nates, puna jashte kohes normale, puna ne ditet e pushimit javor, festave zyrtare.

Mbrojtja ne pune dhe kushtet e punes.

Pushimet dhe mungesat, te drejtat, detyrimet dhe pergjegjesite e punonjesve per zbatimin e detyrave te punes.

Pushimi i marredhenies se punes.

Paga e punes se punonjesit, shperblimi i punes dhe shperblime te tjera.

Shoqeria merr persiper te beje sigurimin e te punesuarve prane saj ne organet perkatese duke derdhur rregullisht kontributet ne perqindjet e caktuara sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

Per te gjitha mosmarreshjet qe mund te lindin gjate veprimtarise se shoqerise dhe qe nuk mund te zgjidhen me mirekuptim, organi kompetent per shqyrtimin e tyre eshte Gjykata e Shkalles se Pare Tirane.

KREU V

MBYLLJA E SHOQERISE

NENI 20


Veprimtaria e shoqerise pushon me propozimin e ortakeve, kur gjate dy vjeteve nuk rezulton rentabel ose kur ortakët heqin dore nga shoqeria si dhe te gjitha rastet qe parashikohen ne dokumentet e krijimit te shoqerise (kontrata). Shoqeria shperndahet ne forme riorganizimi ose likujdimi.

Afati i veprimtarise se shoqerise caktohet me afat te pakufizuar duke filluar nga viti 2006, si vit i pare i veprimtarise.

NENI 21

LIKUJDIMI I SHOQERISE

Asambleja e ortakeve emeron komisionin e likujdimit, te cilit i paraqitet bilanci likujdimit dhe shoqeria i jep fund veprimtarise se saj ne castin e miratimit te ketij bilanci.



Pasurite qe jane vene ne dispozicion te shoqerise me te drejte shfrytezimi, shiten ne vartesi te shkalles se konsumit te tyre. Te ardhurat cedohen ndermjet ortakeve ne perpjetim me kuoten e vene.

Mjetet financiare te fituara si rezultat i veprimtarise se shoqerise e te fililave te saj dhe fondet financiare ndahen ndermjet ortakeve ne perpjestim me kuotat e vena ,pasi te jene bere pagesat per kreditoret.

NENI 22.

Kur pushon veprimtaria e nje filiali ,per efekte te riorganizimit te tij, afatet e pushimit caktohen nga Asamblea e Ortakeve.

Likujdimi i filialeve behet njelloj si per shoqerine.


Mjetet financiare te fituara si rezultat i veprimtarise se filialit te likujduar dhe fondet e tij financiare vihen ne dispozicion te shoqerise pasi t'u jene bere pagesat likujdatoreve.

NENI 23

Ky statut hyn ne fuqi menjehere.

ORTAKET E SHOQERISE

Besnik Aliaj




mob

Klement Kolaneqi



Dritan Shutina

Sotir Dharmo



Gazmend Haxhia

